





# EDUKIMI MJEDISOR



Maj 2026

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.

"Mjedisi është vendi ku të gjithë takohemi; ajo që të gjithë e kemi të përbashkët."

Lady Bird Johnson

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në të 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndër marrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjedisve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes këtij manuali mujor Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, me nxënësit e shkollave tëndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale, përgjatëmuajit maj 2026.

Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë 1823

57 Shkolla të përfshira

Specialistë të angazhuar 24

68 Mësues të përfshirë

Orë mjedisore të realizuara 60



# “EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



## 18 Maj 2026 – Censusi i Pelikanit Kaçurrel

Natyra u kthye në një klasë të hapur mësimi për nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Agim Tafili”, të cilët morën pjesë në Censusin e Pelikanit Kaçurrel (*Pelecanus crispus*), të zhvilluar nga specialistët e AdZM Shkodër në Rezervatin Natyror të Menaxhuar “Liqeni i Shkodrës” dhe Lagunën e Vilunit. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me rëndësinë e ligatinave si habitate të vlefshme për shpendët e rrallë dhe të mbrojtur, duke mësuar më shumë mbi vlerat e biodiversitetit dhe nevojën për ruajtjen e tyre.

## 20 Maj 2026 – Orë mjedisore

AdZM Shkodër organizoi një orë të hapur mjedisore në Shkollën e Mesme të Bashkuar “LucëAgraja”, në një atmosferë të gjallë dhe plot energji pozitive. Aktiviteti u karakterizua nga kreativiteti dhe bashkëpunimi i nxënësve, të cilët sollën një program të larmishëm përmes këngëve, valleve, punimeve kreative, panairit dhe ushqimeve tradicionale. Çdo prezantim pasqyroi talentin, përkushtimin dhe vlerat kulturore që nxënësit mbartin dhe i promovojnë me krenari, duke krijuar një lidhje të ngushtë mes shkollës dhe komunitetit. Aktiviteti shërbeu si një shembull frymëzues i rëndësisë së edukimit dhe nxitjes së ideve kreative tek brezi i ri.

## 21 Maj 2026 – Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Biodiversiteti ishte në qendër të vëmendjes në aktivitetin edukues të zhvilluar me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Hot i Ri”, në kuadër të Ditës Botërore të Biodiversitetit. Përmes prezantimeve, videove edukuese dhe vizatimeve plot krijimtari, nxënësit u njohën me pasurinë e jashtëzakonshme të botës së gjallë dhe rëndësinë që ka ruajtja e saj për të ardhmen e planetit. Aktiviteti synoi të forcojë ndërgjegjësimin e të rinjve për mbrojtjen e natyrës dhe të nxisë angazhimin e tyre në kujdesin ndaj mjedisit.

biodiversitet   Liqeni i Shkodrës   orë mjedisore  
zona të mbrojtura   ekosistem   shtigje të pastra



# “EDUKIMI MJEDISOR”, GJIROKASTËR



## 8 Maj 2026 – Orë mjedisore në natyrë

Në kuadër të aktiviteteve për edukimin mjedisor, specialistët e AdZM Gjirokastrë zhvilluan njëorë mjedisore me nxënësit e klasës së VIII të shkollës 9-vjeçare “Nonda Bulka”, në Përmet. Gjatë aktivitetit u prezantuan informacione mbi rëndësinë e mbrojtjes së shpendëve dhe habitateve të tyre natyrore, si dhe rolin e biodiversitetit në ruajtjen e ekuilibrit natyror. Nxënësiu përfshinë në diskutime dhe ndanë mendime mbi mënyrat se si mund të kontribuojnë në mbrojtjen e natyrës.

## 15 Maj 2026 – Shtigje të pastra, pyje të mbrojtura

Nën moton “Shtigjet e pastra, pyje të mbrojtura”, AdZM Gjirokastrë mori pjesë në organizimin e një aktiviteti në Parkun Natyror “Bredhi i Sotirës”, në bashkëpunim me Shkollën e Mesme të Bashkuar Bularat. Rreth 100 pjesëmarrës përshkuan shtegun nga fshati Sotir drejt Manastirit të Shën Ilias, duke promovuar rëndësinë e ruajtjes së mjedisit, jetesës aktive dhe vlerësimit të pasurive natyrore. Aktiviteti përcolli mesazhe ndërgjegjësuere për mbrojtjen e pyjeve dhe natyrës.

## 19 Maj 2026 – Shpendët shtegtarë

Specialistët e AdZM Gjirokastrë zhvilluan një orë mjedisore në kopshtin “Cicërimat”, Gjirokastrë, me temë “Shpendët Shtegtarë”. Fëmijët u njohën me disa lloje shpendësh shtegtarë, rëndësinë e habitateve natyrore dhe nevojën për mbrojtjen e tyre. Aktiviteti synoi rritjen e ndërgjegjësimit për ruajtjen e biodiversitetit që në moshë të hershme.

ditë botërore vlera natyrore monument natyre  
mbrojta e natyrës orë mjedisore flora e zonave të mbrojtura



## 20 Maj 2026 – Dita Botërore e Bletëve

Në kuadër të Ditës Botërore të Bletëve, AdZM Gjirokastrë zhvilloi një aktivitet edukativ me grupin parashkollor të kopshtit "Cicërimat". Nëpërmjet prezantimeve, materialeve informuese dhe ndërtimit të hojeve simbolike të bletëve, fëmijët mësuuan mbi rolin e bletëve në pllënimin e bimëve, prodhimin ushqimor dhe ruajtjen e biodiversitetit.

---

## 20 Maj 2026 – Fauna në zonat e mbrojtura

AdZM Gjirokastrë zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e klasës së IV të shkollës "7 Marsi", Tepelenë. Gjatë aktivitetit nxënësit u njohën me llojet kryesore të faunës së zonave të mbrojtura, rëndësinë e ruajtjes së tyre dhe rolin që secili individ ka në mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit.

---

## 22 Maj 2026 – Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Në Ditën Ndërkombëtare të Biodiversitetit, specialistët e AdZM Gjirokastrë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së VI të shkollës "Meleq Gosnishti", Përmet. Gjatë aktivitetit u prezantuan vlerat e florës dhe faunës së Parkut Kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli", duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit dhe mbrojtjes së habitateve natyrore.

---

## 22 Maj 2026 – Parku Kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli"

Për të promovuar vlerat e Parkut Kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli", specialistët e AdZM Gjirokastrë zhvilluan një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare "At Stath Melani" në Petran, me nxënësit e kësaj shkolle. Gjatë aktivitetit u fol për biodiversitetin e pasur të parkut, rëndësinë e ruajtjes së pyjeve dhe mbrojtjen e ekosistemeve natyrore, duke synuar rritjen e ndërgjegjësisimit mjedisor dhe nxitjen e dashurisë për natyrën.



## 28 Maj 2026 – Kamerat kurth në zonat e mbrojtura

Në kopshtin "Soros", Gjirokastrë, u zhvillua një aktivitet edukues me fëmijët e grupit parashkollor me temë "Kafshët e Zonave të Mbrojtura". Fëmijët u njohën me specie të ndryshmetë faunës shqiptare dhe me përdorimin e kamerave kurth për monitorimin e kafshëve në habitatete tyre natyrore. Aktiviteti përcolli mesazhe për mbrojtjen e biodiversitetit dhe respektin ndajnatyrës.

# “EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR



## 8 Maj 2026 – Orë mjedisore

Specialistët e AdZM Dibër zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës “Papa Gjon Pali”, Ulëz, me temë “Si të realizojmë një zog”. Gjatë aktivitetit nxënësit u njohën me lloje të ndryshme zogjsh, mënyrën e jetesës së tyre dhe shtegtimin e shpendëve. Përmes një punekrijuese, ata ndërtuan shtëpi për zogjtë duke përdorur materiale të thjeshta dhe shprehën mendimet e tyre mbi rëndësinë e mbrojtjes së shpendëve dhe habitateve natyrore.

## 22 Maj 2026 – Riciklimi dhe mbrojtja e mjedisit

Në kuadër të aktiviteteve për edukimin mjedisor, AdZM Dibër zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e klasës së IV të shkollës 9-vjeçare “Gjergj Kastrioti”, Baz, me temë “Riciklimi dhe mbrojtja e mjedisit”. Gjatë aktivitetit u diskutua mbi rëndësinë e riciklimit, mbrojtjen e mjedisit dhe kujdesin ndaj shpendëve. Nxënësit u angazhuan në punë krijuese duke realizuar modele pemësh për zogjtë dhe ndanë mendimet e tyre mbi mënyrat se si secili mund të kontribuojë në mbrojtjen e natyrës.

## 28 Maj 2026 – Orë Mjedisore

AdZM Dibër zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Karic”, me temë “Breshka e tokës”. Gjatë aktivitetit nxënësit mësuuan mbi breshkën e tokës, habitatin, riprodhimin dhe mënyrën e ushqyerjes së saj. Përmes diskutimeve dhe aktiviteteve praktike, u theksua rëndësia e mbrojtjes së kësaj specijeje dhe e ruajtjes së habitateve natyrore. Në përfundim, nxënësit realizuan vizatime të breshkës së tokës, duke shprehur njohuritë e fituara gjatë aktivitetit.

orë mjedisore ndërgjegjësim

biodiversitet mjedis i pastër ekosistem turizëm malor



# “EDUKIMI MJEDISOR”, BERAT



## 6 Maj 2026 – Shtigje të pastra, pyje të mbrojtura


Në kuadër të programit kombëtar “Shtigje të Pastra, Pyje të Mbrojtura”, specialistët e AdZM Berat, në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Kareman Ylli” Bogovë, zhvilluan një aktivitet në natyrë në Monumentin e Natyrës “Ujëvara e Bogovës”. Përmes ecjes dhe pastrimit të zonës, nxënësit u bënë pjesë e kujdesit për mjedisin dhe u ndërgjegjësuan për rëndësinë e ruajtjes së hapësirave natyrore dhe mbrojtjes së biodiversitetit.

## 22 Maj 2026 – Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

AdZM Berat zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës “Mehmet Qypri” Roshnik, me fokus temën “Biodiversiteti”. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me rëndësinë e ruajtjes së natyrës, mbrojtjen e specieve dhe vlerat e biodiversitetit për jetën dhe ekosistemet. Ora u shoqërua me diskutime dhe pyetje, duke nxitur ndërgjegjësimin e nxënësve për mbrojtjen e mjedisit dhe kujdesin ndaj natyrës.

edukim mjedisor biodiversitet monument natyre  
ditë botërore riciklim mjedis i shëndetshëm





## 9 Maj 2026 – Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë

Në kuadër të Ditës Botërore të Shpendëve Shtegtarë, specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së VI të shkollës 9-vjeçare “Mustafa Kacaci”, Krujë. Gjatë aktivitetit u diskutua mbi rëndësinë e zogjve në natyrë dhe nevojën për mbrojtjen e tyre. Nxënësit u angazhuan në aktivitete krijuese, piktura dhe punime tematike, duke përcjellë mesazhe për dashurinë ndaj natyrës dhe biodiversitetit.

## 13 Maj 2026 – Shtigje të pastra, pyje të mbrojtura

Në kuadër të nismës “Shtigje të pastra, pyje të mbrojtura”, specialistët e AdZM Durrës organizuan një aktivitet markimi dhe pastrimi në shtegun “Rruga e Malit të Krujës – MN Sarisalltik”, me pjesëmarrjen e nxënësve të gjimnazit “Skënderbeu”, Krujë. Rreth 250 nxënës morën pjesë në aktivitet, duke kontribuar në pastrimin e shtegut dhe duke përcjellë mesazhe për mbrojtjen e natyrës, ruajtjen e zonave të mbrojtura dhe parandalimin e zjarreve në pyje.

## 15 Maj 2026 – Ndryshimet klimatike

Specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Myrteza Hamit Pengili”, Krujë. Nëpërmjet bashkëbisedimeve dhe aktiviteteve praktike, nxënësit u njohën me ndryshimet klimatike, shkaqet dhe pasojat e tyre, si dhe me rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit për një të ardhme më të qëndrueshme. Aktiviteti synoi rritjen e ndërgjegjësimit të brezit të ri për sfidat mjedisore globale.

## 22 Maj 2026 – Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Biodiversitetit, specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së VII të shkollës 9-vjeçare “Selman Ali Xaka”, Nuaj. Gjatë aktivitetit u prezantua rëndësia e biodiversitetit dhe roli i tij në ruajtjen e ekuilibrit natyror. Nxënësit u përfshinë në diskutime dhe aktivitete krijuese, duke mësuar mbi nevojën për mbrojtjen e specieve dhe habitateve natyrore për brezat e ardhshëm.

# “EDUKIMI MJEDISOR”, LEZHË



biodiversitet rëndësia e bletëve edukim mjedisor  
ditë botërore parqe kombëtare



## 11 Maj 2026 – Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë

Shpendët shtegtarë kanë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e ekuilibrit natyror dhe biodiversitetit. Mbrojtja e habitateve të tyre ndihmon në ruajtjen e ekosistemeve dhe të shumë specieve të tjeranë natyrë. Stafi i AdZM Lezhë zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës “Karl Gega”. Gjatë aktivitetit u prezantua një material informues mbi disa lloje shpendësh dhe rëndësinë e tyre në ekosistem. Nxënësit u angazhuan në diskutime dhe aktivitete mbi rolin e shpendëve në natyrë.

## 20 Maj 2026 – Dita Botërore e Bletëve

Bletët janë ndër speciet më të rëndësishme për jetën në tokë, pasi kontribuojnë në pllenimin e bimëve dhe prodhimin ushqimor. Ruajtja e tyre është thelbësore për mbrojtjen e biodiversitetit dhe ekuilibrin natyror. Specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës III të shkollës së bashkuar “Ndoc Gjetja”. Nëpërmjet materialeve informuese dhe aktiviteteve kreative, nxënësit u njohën me rëndësinë e bletëve në ekosistem dhe nevojën për mbrojtjen e tyre.

## 22 Maj 2026 – Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Biodiversiteti përfaqëson larminë e gjallesave dhe është baza e funksionimit të ekosistemeve natyrore. Ruajtja e tij është e rëndësishme për një mjedis të shëndetshëm dhe për të ardhmen e brezave të rinj. Specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore në terren me nxënësit e klasës VI të shkollës 9-vjeçare “Zejmen”. Përmes bashkëbisedimeve dhe aktivitetit edukues “kërkimi i thesarit”, nxënësit mësuan mbi rëndësinë e biodiversitetit dhe ruajtjen e ekosistemeve natyrore.



## 24 Maj 2026 – Dita Europiane e Parqeve

Parqet kombëtare mbrojnë pasuritë natyrore, biodiversitetin dhe peizazhet me vlera të veçanta. Edukimi i fëmijëve mbi rëndësinë e tyre ndihmon në krijimin e një kulture për mbrojtjen e natyrës. Staf i AdZM Lezhë zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e klasës V të shkollës 9-vjeçare "Fran Ivanaj". Nëpërmjet aktivitetit "Misioni i Eksploruesve", nxënësit u njohën me vlerat e parqeve kombëtare dhe përgatitën postera kreativë me mesazhe sensibilizuese për mbrojtjen e natyrës.

## 25 Maj 2026 – Orë mjedisore

Breshkat e tokës janë pjesë e rëndësishme e ekosistemeve natyrore dhe konsiderohen specie që kanë nevojë për mbrojtje. Ruajtja e habitateve të tyre ndihmon në mbrojtjen e biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore. Staf i AdZM Lezhë zhvilloi një orë mjedisore në terren me nxënësit e klasës VI të shkollës së bashkuar "Ndoc Gjetja". Gjatë aktivitetit, nxënësit krijuan "breshkën natyrore" duke përdorur materiale të mbledhura në natyrë.

# “EDUKIMI MJEDISOR”, TIRANË



## 9 Maj 2026 – Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë

Me rastin e Ditës Botërore të Shpendëve Shtegtarë, u zhvillua një aktivitet edukativ me nxënësitë e klasës së pestë të Shkollës 9-vjeçare “Tufinë”. Përmes punimeve origami dhe përgatitjes së enëve me ushqim për zogjtë, fëmijët mësuan më shumë mbi rëndësinë e mbrojtjes së shpendëve dhe habitatit të tyre natyror. Aktiviteti synoi të nxisë kujdesin ndaj botës së gjallë dhe përgjegjësinë për ruajtjen e biodiversitetit.

## 20 Maj 2026 – Dita Botërore e Bletëve

Në kuadër të edukimit mjedisor dhe ndërgjegjësimit për rëndësinë e pjalmuesve në natyrë, specialistët e AdZM-së zhvilluan një aktivitet me nxënësit e Shkollës së Ciklit të Ulët “Brar”, PK “Mali i Dajtit”. Gjatë orës mjedisore, nxënësit u njohën me rolin e bletës në ekosisteme dhe me vlerat ushqyese të mjaltit, ndërsa realizuan punime kreative në formën e koshereve dhe bletëve.

## 22 Maj 2026 – Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Ruajtja e biodiversitetit është thelbësore për ekuilibrin e natyrës dhe mirëqenien e njeriut. Me këtë mesazh u zhvillua aktiviteti me nxënësit e klasës së shtatë të Shkollës së Mesme të Bashkuar “Bahri Nela”, Zall Bastar. Përmes diskutimeve dhe punimeve krijuese me materiale natyrore, nxënësit u njohën me vlerat e biodiversitetit dhe rëndësinë e mbrojtjes së tij për brezat e ardhshëm.

## 23 Maj 2026 – Dita Botërore e Breshkave

Përmes artit dhe krijimtarisë, nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Tufinë” përcollën mesazhe sensibilizuese për mbrojtjen e breshkave dhe të natyrës. Aktiviteti u shoqërua me krijimin e një breshke të zbukuruar me lule dhe gjethë, duke kombinuar mësimin me argëtimin dhe duke forcuar ndjenjën e respektit ndaj gjallesave.

ndërgjegjësim mjedisor përgjegjësi mjedisore  
biodiversitet, krijimtari art dhe natyrë

## 10 Maj 2026 – Aktivitet pastrimi në Zall Dajt

Pastrimi i mjedisit është një nga mënyrat më të drejtpërdrejta për të kontribuar në mbrojtjen e natyrës. Me këtë frymë, nxënësit e klasave 7–9 të shkollës 9-vjeçare “Hamdi Mancaku”, Zall Dajt, u angazhuan në një aksion pastrimi, duke mbledhur mbetjet dhe duke dhënë një shembull pozitiv të qytetarisë aktive dhe përgjegjësive mjedisore.



# “EDUKIMI MJEDISOR”, ELBASAN



**9 Maj 2026** – Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë  
Në kuadër të Ditës Botërore të Shpendëve shtegtarë, specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan njëorë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Vilson Blloshmi” në Librazhd. Përmes bisedave, aktiviteteve krijuese dhe punimeve artistike, nxënësit u njohën me rëndësinë e shpendëve në ekosistem dhe me nevojën për mbrojtjen e habitateve të tyre natyrore. Aktiviteti përcolli mesazhetë rëndësishme mbi kujdesin ndaj natyrës dhe biodiversitetit.

**12 Maj 2026** – Orë mjedisore dhe aktivitet pastrimi  
Specialistët e AdZM Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Veiz Çota” në Togëz, pranë Parkut Kombëtar “Shebenik”. Pas diskutimeve mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, nxënësit u angazhuan në një aktivitet pastrimi në ambientet e shkollës dhe zonëpërreth saj. Aktiviteti synoi nxitjen e përgjegjësisë qytetare dhe ndërgjegjësimin për ruajtjen e natyrës.

**18 Maj 2026** – Njohja me vlerat e zonave të mbrojtura  
Në afërsi të Peizazhit të Mbrojtur “Kuturman-Qaf Bush”, specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare Qerret. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me vlerat natyrore të zonës, biodiversitetin dhe veçanërisht me faunën e pasur që ajo strehon. Ora mjedisore shërbeu për të afruar të rinjtë me natyrën dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbirëndësinë e mbrojtjes së saj.

**19 Maj 2026** – Shtigje të pastra, pyje të mbrojtura  
Në Parkun Kombëtar “Shebenik” u zhvillua nisma “Shtigje të Pastra, Pyje të Mbrojtura”, me pjesëmarrjen e nxënësve nga shkolla të ndryshme dhe në bashkëpunim me Albnatyrë Org. Gjatë aktivitetit u pastrua Shtegu i Bicikletave, duke kontribuar në ruajtjen e ekosistemit dhe reduktimin e mbetjeve në natyrë. Veprimtaria synoi të promovojë kujdesin ndaj mjedisit dhe rëndësinë e angazhimit të komunitetit në mbrojtjen e zonave të mbrojtura.

Parku Kombëtar “Shebenik” Ndërgjegjësim biodiversitet  
ruajtja e mjedisit pjesëmarrje rinore zona të mbrojtura

## 20 Maj 2026 – Dita Botërore e Bletëve

Në kuadër të Ditës Botërore të Bletëve, AdZM Elbasan zhvilloi një aktivitet edukues me fëmijë të Kopshtit Nr. 1 në Librazhd. Përmes lojërave, bisedave dhe punimeve krijuese, vogëlushët mësuan mbi rolin e bletëve në natyrë dhe rëndësinë e tyre për biodiversitetin. Aktiviteti u shoqërua me krijimin e punimeve tematike, duke e kthyer orën mjedisore në një përvojë të këndshme dhe edukative.

## 22 Maj 2026 – Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Biodiversitetit, specialistët e AdZM Elbasan organizuan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Shefqet Dosku” në Dorëz. Gjatë aktivitetit u diskutua mbi rëndësinë e biodiversitetit dhe rolin e tij në ruajtjen e ekuilibrit natyror. Nxënësit u angazhuan në punime dhe krijime të ndryshme që pasqyronin pasurinë e jetës në natyrë.

## 23 Maj 2026 – Dita Botërore e Breshkave

Në kuadër të Ditës së Tokës, u zhvillua një aktivitet pastrimi me pjesëmarrjen e AdZM Elbasan, organizatave mjedisore dhe nxënësve nga shkolla të ndryshme të qytetit. Aktiviteti u shoqërua e dhe me një ecje në shtegun “Qafë Shapkë – Maja e Qafë Shapkës”, duke përcjellë mesazhin për mbrojtjen e planetit.

## 24 Maj 2026 – Dita Evropiane e Parqeve

Në kuadër të Ditës Evropiane të Parqeve, specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “18 Gushti” në Gramsh. Aktiviteti u fokusua në njohjen e zonave të mbrojtura, vlerave dhe rëndësisë së tyre për ruajtjen e biodiversitetit. Në bashkëpunim me shkollën u përgatit edhe një stendë informuese mbi monumentet natyrore të Bashkisë Gramsh.

## 27 Maj 2026 – Orë mjedisore

AdZM Elbasan realizoi një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Ahmet Elezi” në Stravaj, pranë Rezervatit Natyror të Menaxhuar “Stravaj-Sopot”. Gjatë aktivitetit u diskutua mbi rëndësinë e ruajtjes së natyrës dhe vlerat e zonave të mbrojtura. Ora mjedisoresynoi të afrojtë të rinjtë me natyrën dhe të nxisë ndjenjën e përgjegjësisë për mbrojtjen e saj.



29 Maj 2026 – Orë mjedisore

Në shkollën 9-vjeçare "Librazhd Katund", specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan një orë mjedisore të kombinuar me aktivitet pastrimi në ambientet e shkollës dhe zonën përreth. Nxënësit u angazhuan aktivisht në pastrimin e mjedisit, duke mësuar njëkohësisht mbi ndikime mbetjeve në natyrë dhe rëndësinë e sjelljeve të përgjegjshme ndaj mjedisit. Aktiviteti shërbeu si një shembull praktik i edukimit mjedisor në veprim.



# “EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



## 6 Maj 2026 – Shtigje të pastra, pyje të mbrojtura

Në kuadër të nismës “Shtigje të Pastra, Pyje të Mbrojtura”, AdZM Fier zhvilloi një aktivitet pastrimi në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta, përgjatë Shtegut të Pelikanit. Në bashkëpunim me nxënësit e shkollave të Bashkisë Divjakë, u krye pastrimi i shtegut nga drurët e rrëzuar për të mundësuar aksesin e mjeteve të patrullimit dhe zjarrfikëses në rast emergjencash. Aktiviteti synoi të nxistë ndërgjegjësimin e të rinjve për mbrojtjen e natyrës dhe mirëmbajtjen e zonave të mbrojtura.

## 10 Maj 2026 – Aktivitet ndërgjegjësues për pelikanin kaçurrel

AdZM Fier, në bashkëpunim me Shoqatën Ornitologjike të Shqipërisë (AOS) dhe Shoqatën Horizont EU, zhvilloi një aktivitet edukues me nxënësit e Shkollës së Mesme “Mihal Nako” në Fier. Gjatë vizitës në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta, nxënësit u njohën me vlerat natyrore të parkut dhe rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit, ndërsa vrojtuan habitatin e pelikanit kaçurrel dhe mësuuan më shumë për mbrojtjen e kësaj specije të rrallë.

## 12 Maj 2026 – Lojërat olimpike në natyrë

Në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta u zhvilluan “Lojërat Olimpike”, të organizuara ngashkolla 9-vjeçare “Karavasta e Re”. Përmes lojërave sportive dhe aktiviteteve argëtuese, nxënësit promovuan frymën e bashkëpunimit, respektit dhe garës së ndershme. Aktiviteti kontribuoi në forcimin e lidhjes së fëmijëve me natyrën dhe vlerat që ofrojnë zonat e mbrojtura.

## 12 Maj 2026 – Praktikë mësimore me studentët e gjeografisë

Studentët e vitit të parë Bachelor në Gjeografi zhvilluan një praktikë mësimore në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta. Nën asistencën e specialistëve të AdZM Fier, ata u njohën me peizazhet natyrore bregdetare, ekosistemet lagunore dhe proceset gjeografike që karakterizojnë këtë zonë të mbrojtur. Praktika shërbeu për të thelluar njohuritë mbi ndërvëprimin mes natyrës dhe aktivitetit njerëzor, si dhe mbi rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit.

orë mjedisore edukim ndërgjegjësim

tokë e shëndetshme park kombëtar peisazhe bregdetar



## 22 Maj 2026 – Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Në kuadër të Ditës Botërore të Biodiversitetit, nxënësit dhe mësuesit e Shkollës së Bashkuar "Grabian", në bashkëpunim me specialistët e AdZM Fier, zhvilluan një aktivitet edukues dhe ndërgjegjësues. Përmes krijimit të herbariumeve me bimë të mbledhura në zonë, nxënësit u njohën me florën vendase dhe me rëndësinë e ruajtjes së ekosistemeve. Aktiviteti përcolli mesazhe për mbrojtjen e natyrës dhe pasurive natyrore për brezat e ardhshëm.

---

## 24 Maj 2026 – Dita Evropiane e Parqeve

Në kuadër të Ditës Evropiane të Parqeve, studentët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës zhvilluan një praktikë mësimore në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta. Gjatë aktivitetit, studentët u njohën me metodat e studimit të florës dhe vegjetacionit, si dhe me vlerat natyrore të parkut. Specialistët e AdZM Fier prezantuan rëndësinë e habitateve natyrore, specieve të rralla dhe shërbimeve ekosistemore që ofron kjo zonë e mbrojtur, duke theksuar rolin e saj në zhvillimin e qëndrueshëm dhe edukimin mjedisor.

# “EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



biodiversitet habitate natyrore ekosisteme  
shteg përgjegjësi mjedisore zona të mbrojtura



**13 Maj 2026** – Shtigje të pastra, pyje të mbrojtura  
Në kuadër të nismës kombëtare “Shtigje të Pastra”, specialistët e AdZM Kukës, në bashkëpunim me nxënësit e shkollave 9-vjeçare Novosej dhe Shishtavec, realizuan shënjimimin dhe mirëmbajtjen e shtegut turistik “Liqeni i Novosej – Turajt” në Parkun Natyror Korab-Koritnik. Aktiviteti synoi përmirësimin e orientimit dhe sigurisë së vizitorëve, promovimin e turizmit të qëndrueshëm dhe ndërgjegjësimin e të rinjve për rëndësinë e mbrojtjes së natyrës dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës turistike.

**20 Maj 2026** – Dita Botërore e Bletëve  
Në kuadër të Ditës Botërore të Bletëve, specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë edukimi mjedisor me nxënësit e shkollës së bashkuar “Imer Mata” në Zapod. Aktiviteti u fokusua në rëndësinë e bletëve për biodiversitetin, pllenimin e bimëve dhe ruajtjen e ekuilibrave natyrore. Më pas, nxënësit morën pjesë në një aktivitet pastrimi dhe organizuan një ekspozitë me vizatime kushtuar mbrojtjes së mjedisit, duke përcjellë mesazhe për ruajtjen e natyrës dhe kujdesin ndaj mjedisit.

**22 Maj 2026** – Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit  
Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Biodiversitetit, specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë edukimi mjedisor me nxënësit e shkollës 9-vjeçare Novosej. Gjatë aktivitetit u diskutua mbi rëndësinë e biodiversitetit, mbrojtjen e florës dhe faunës, si dhe ruajtjen e ekosistemeve natyrore. Aktiviteti u shoqërua me një aksion pastrimi në territorin e Parkut Natyror Korab-Koritnik, duke nxitur përgjegjësinë qytetare dhe kujdesin për mjedisin.

## 25 Maj 2026 –Dita Europiane e Parqeve

Në kuadër të Ditës Europiane të Parqeve, specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë edukimi mjedisor me nxënësit e shkollës "Lidhja e Prizrenit" në Kukës. Nxënësit u njohën me vlerat natyrore të Parkut Natyror Korab-Koritnik, rëndësinë e zonave të mbrojtura dhe rolin e tyre në ruajtjen e biodiversitetit. Aktiviteti synoi të forcojë ndërgjegjësimin dhe përgjegjësinë e të rinjve për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe mjedisit.



# “EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



biodiversitet shtigje të pastra ndërgjegjësimit

turizëm mjedis i shëndetshëm fauna e egër zona të mbrojtura



## 11 Maj 2026 – Shtigje të pastra, pyje të mbrojtura

Në kuadër të nismës mjedisore “Shtigje të Pastra”, në Parkun e Çangonjit u zhvillua një aksion pastrimi me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollës “Fuat Babani” dhe përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme. Gjatë aktivitetit u pastruan hapësirat e gjelbra dhe u përcollën mesazhe ndërgjegjësuere për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit. Aktiviteti tregoi se përmes bashkëpunimit dhe angazhimit të përbashkët mund të kontribuojmë për një mjedis më të pastër dhe më të shëndetshëm.

## 14 Maj 2026 – Orë mjedisore

Në shkollën “Stavri Themeli” në Korçë, specialistët zhvilluan një orë edukimi mjedisor me nxënësit e klasës së pestë mbi rëndësinë e ujit për jetën. Nxënësit prezantuan informacione dhe këshilla praktike për kursimin e ujit, ndërsa diskutuan mbi nevojën për mbrojtjen e burimeve ujore. Aktiviteti synoi të forcojë ndërgjegjësimin e tyre për përdorimin e përgjegjshëm të këtij burimi jetik.

## 15 Maj 2026 – Ndryshimet klimatike dhe mbrojtja e mjedisit

Me nxënësit e shkollës “14 Ëngjëjt” në Buçimas u zhvillua një aktivitet edukues nga specialistët e AdZM Korçë, kushtuar ndryshimeve klimatike. Gjatë diskutimeve u trajtuan shkaqet dhe pasojat e ngrohjes globale, si dhe mënyrat se si secili mund të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit. Nëpërmjet shembujve konkretë, nxënësit u ndërgjegjësuat për rëndësinë e veprimit të përgjegjshëm ndaj klimës.

## 15 Maj 2026 – Orë mjedisore

Në shkollën "Sevasti Qirjazi" në Korçë u zhvillua një orë edukimi mjedisor me nxënësit e klasës së katërt, kushtuar zonave të mbrojtura. Fëmijët mësuan mbi rëndësinë e tyre për ruajtjen e biodiversitetit dhe vlerave natyrore. Përmes lojërave edukative dhe quiz-eve argëtuese, ata përvetësuan njohuri të reja dhe shprehën interes për mbrojtjen e natyrës.

## 21 Maj 2026 – Orë mjedisore

Specialistët e AdZM Korçë, në bashkëpunim me KRWM, zhvilluan një aktivitet edukimi mjedisor me nxënësit e shkollës "Skënderbeu" në Maliq. Gjatë aktivitetit u diskutua mbi rëndësinë e biodiversitetit, vlerat natyrore të zonës dhe nevojën për ruajtjen e tyre. Nxënësit u njohën gjithashtu me procesin e riciklimit dhe ndikimin pozitiv që ai ka në mbrojtjen e mjedisit. Në përfundim të aktivitetit, së bashku u mbollën fidane bliri, duke përcjellë mesazhin e kujdesit dhe përgjegjësisë ndaj natyrës.

## 22 Maj 2026 – Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Biodiversitetit, specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një orë edukimi mjedisor me nxënësit e klasës së 11-të të shkollës "Gjergj Pekmezi" në Pogradec. Gjatë aktivitetit u prezantuan vlerat e pasura natyrore të zonave të Prespës dhe Pogradecit, duke u ndalur te larmia e bimëve dhe kafshëve që jetojnë në këto ekosisteme të rëndësishme. Nëpërmjet diskutimeve dhe shkëmbimit të ideve, nxënësit u ndërgjegjësuan për rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit dhe rolin që secili prej nesh ka në mbrojtjen e kësaj pasurie natyrore për brezat e ardhshëm.



# “EDUKIMI MJEDISOR”, VLORË



**19 Maj 2026** – Orë mjedisore mbi jetën dhe rëndësinë e breshkave detare  
Në Qendrën e Rehabilitimit të Breshkave të Detit në Vlorë u zhvillua një orë mjedisore me studentët e vitit të parë të degës Kimi në Universitetin “Ismail Qemali”. Specialistët e AdZMVlorë i njohën pjesëmarrësit me jetën dhe rëndësinë e breshkave detare, si dhe me rreziqet që ndikojnë në folezimin e tyre. U trajtuan gjithashtu protokollat e monitorimit që zbatohen në këtë periudhë për mbrojtjen e kësaj specijeje të rëndësishme për ekosistemin detar. Aktiviteti synoi rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve për mbrojtjen e biodiversitetit detar.

**22 Maj 2026** – Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit  
Në kuadër të Ditës Botërore të Biodiversitetit, specialistët e AdZM Vlorë, në bashkëpunim me shoqatën “Flag Pine”, zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës “Elite” në Vlorë. Përmes videove edukuese dhe prezantimeve interaktive, nxënësit u njohën me rëndësinë e biodiversitetit dhe rolin e çdo hallke në ruajtjen e ekuilibrit natyror.

**26 Maj 2026** – Dita Botërore e Tokës  
Në kuadër të Ditës Europiane të Parqeve, specialistët e AdZM Vlorë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës “Elite”. Gjatë aktivitetit, fëmijët u njohën me rëndësinë e parqeve kombëtare dhe zonave të mbrojtura, si dhe me biodiversitetin e pasur të vendit tonë. Përmes diskutimeve dhe aktiviteteve ndërvepruese, ata u angazhuan në mënyrë aktive në mbrojtjen e natyrës.

**25 Maj 2026** – Dita Botërore pa Plastikë  
Në kuadër të Ditës Botërore pa Plastikë, specialistët e AdZM Vlorë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës “Elite”. Gjatë aktivitetit u diskutua mbi ndotjen plastike dhe ndikimin e saj në det, oqeanë dhe gjallesat ujore. Nxënësit u ndërgjegjësuam për rëndësinë e reduktimit të plastikës në jetën e përditshme dhe për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit.